



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:179675

Datë: 24.09.2024

Numri i dokumentit: 06197998

C-IV-22-0297

Parashtruesi i kërkesës

M H nga fshati R, Komuna e Prizrenit, të cilin e përfaqëson avokati B I nga Prishtina

kundër

Pala kundërshtare

Agjencioni Kosovar i Privatizimit- AKP (NSH “NIN Ramiz Sadiku” në likuidim), Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishte, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 24 shtator 2024 lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- I. Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRZ017-0004/0140 datë 10 mars 2014.**
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 18 prill 2014, pranë DHPGJS, ankuesja parashtror kërkesë, të emërtuar ankesë, për rishikimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) PRZ017-0004/0140 të datës 10 mars 2014 (në tekstin e mëtutjeshëm Vendimi), me të cilin i është refuzuar kërkesa për kompensimin e pagave të papaguara, për periudhën nga 1 korrik 1999 deri më 19 dhjetor 2005, në shumë prej 7,803.00 (shtatë tetë zero tre) Euro, ndaj NSH “NIN Ramiz Sadiku” (në likuidim).

Ankuesja pohoj se pranë NSH ishte e punësuar gjer me datën e privatizimit të saj, 24 mars 2006. Sipas ankueses, asaj si dhe të gjithë punësuarve të tjerë AKP-ja ju ka ndërprerë punën këtyre punëtorëve, përmes një njoftimi.

Ankuesja të drejtës së tij mbi pagat i referohet dispozitave ligjore të Rregullores së UNMIK-ut 2001/27 dhe 2005/48 respektivisht Ligjit të punës.

Ankuesja i referohet listës së pagave dhe përfshirjes së tij në po këtë listë.

Ankuesja konsideron se Vendimet e AL, në përgjithësi, janë vetëm një formë standarde të pa-arsyetuara edhe pse ato gjithherë duhet të arsyetohen individualisht. Si rezultat i kësaj praktike, sipas ankueses, është pengimi dhe krijimi i shumë vështirësive për punëtorët që ti realizojnë të drejtat e tyre ligjore të garantuara sipas ligjit dhe Kushtetutës së Kosovës.

Ankuesja tutje kundërshtoj Vendimin e AL, lidhur me parashkrimin ashtu që konsideron se Ligji për Punën e bashkuar – LPB i aplikuar nga ana e AL, është ligji i shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit mbi ndërmarrjet (gazeta zyrtare RSFJ nr. 77/88) i cili është ligj i aplikueshëm sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 mbi Ligjin e zbatueshëm në Kosovë.

Sipas ankueses, AL në vend se të shfrytëzoj arkivin e NSH, në të cilën gjendet dokumentacioni i çdo punëtori, kërkon nga punëtorët që kërkesat e tyre ti argumentojnë me prezantimin e dokumentacionit.

Ankuesja konsideron se asaj, në pajtim me të Rregullores së UNMIK-ut 2001/27 dhe 2005/48 respektivisht Ligjit të punës dhe Ligjit për AKP, i takon kompensimi mbi pagat e pa-paguara. Ankuesja sa i përket dispozitave ligjore të Ligjit për AKP dhe Shtojcës së saj i referohet neneve 40 paragrafi 1.6 dhe 1.6.1 si dhe nenit 37. Ankuesja i referohet edhe vendimeve të DHPGJS.

Nga gjitha arsyet, propozon gjykatës që të aprovon kërkesën, për kompensimin e pagave, duke përfshirë edhe kamatën ligjore në lartësi prej 10%.

Kërkesës për rishikim i janë bashkangjitur:

- Kopja e Autorizimit për përfaqësuesin, dhe
- Kopja e Vendimit të AL.

Me 30 shtator 2015, nga përfaqësuesi i ankueses u parashtrua një parashtrësë mbi plotësimin e kërkesës për rishikim-ankesës.

Ankuesi edhe me anë të kësaj parashtrësë mbeti në tërësi si pranë kërkesës për rishikim-ankesës. Ankuesi fillimisht zbret shumën e kërkuar nga shuma prej 7,803.00 Euro tani në shumë prej 3,806.00 (tre tetë zero gjashtë) Euro. Sikurse edhe në kërkesën për rishikim – ankesë ankuesi i referohet dispozitave të njëjta ligjore, mbi parashkrimin e kërkesave dhe shton dispozitat ligjore të Ligjit për procedurën kontestimore, ato të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve si dhe Konventës Europiane mbi liritë dhe të drejtat e njeriut – KELDNJ. Ankuesi i referohet vendimeve të DHPGJS si dhe Vendimeve të Gjykatës Europiane mbi liritë dhe të drejtat e njeriut. Ankuesi përfundimisht përveç shumës së kërkuar në lartësi prej 3,806.00 (tre tetë zero gjashtë) Euro në emër të kamatë vonesave kërkoj shumën totale prej 1,845.91 (një tetë katër pesë nëntë një) Euro.

Gjykata me Aktvendimin C-IV-14-1768 datë 20 maj 2021, ankesën e ankuesit e konsideroj të tërhequr për shkak të mos pagesës së taksave.

Kolegji i Apelit i DHPGJS (KA), me Aktvendimin e saj AC-I-21-0378 datë 31 gusht 2022, aprovoj ankesën e AKP dhe anuloi Aktvendimin e gjykatës datë 20 maj 2021.

KA në arsyetimin e vendimit, theksoj që gjykata duhet të vendos paraprakisht sipas kërkesës për lirim nga pagesa e taksave gjyqësore.

Gjykata me Aktvendimin e saj, C-IV-22-0297 datë 24 janar 2023, refuzoj kërkesën e ankueses për lirim nga pagesa e taksave gjyqësore.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 26 shkurt 2024 parashtroj përgjigjen.

AKP kundërshtoj ankesën si të pabazuar. Sipas AKP AL me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e ankueses ka vendosur në mënyrë të drejtë. AKP tutje pohon se ankuesja nuk ka ofruar argumente ligjore, në favor të ankesës së saj, ashtu siç parashihet sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. AKP përfundimisht pohon se kërkesa kreditore e ankueses konsiderohet e parashkruar në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për punën e bashkuar-LPB respektivisht të pabazuara sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. AKP i referohet Vendimeve të gjykatës. Nga gjitha arsyet propozoj që kërkesa për rishikim të hedhet si e papranueshme ose refuzohet si e pabazuar dhe Vendimi i AL të vërtetohet.

Përgjigjes i është bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL-së.

Duke vepruar sipas urdhrin të gjykatës, ankuesja me 6 mars 2024 parashtroj përgjigjen ndaj përgjigjes së AKP.

Edhe me anë të kësaj përgjigje, ankuesja mbeti në tërësi si pranë kërkesës për rishikim dhe parashtrësës mbi plotësimin e kërkesës për rishikim ashtu që kundërshtoj pretendimet e AL lidhur me parashkrimin dhe kërkoj që kërkesa e tij të aprovohet.

Përfaqësuesi i ankueses kërkoj kompensimin e shpenzimeve gjyqësore në shumë totale prej 343.00 dhe atë në emër të kërkesës së parashtruar pranë AL, shqyrtimit të shkresave të lëndës, kërkesës për rishikim-ankesës, përgjigjes ndaj përgjigjes së AKP dhe taksave gjyqësore të paguara.

Përgjigjes i janë bashkangjitur:

- Kopja e Njoftimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, lëshuar nga Agjencia, datë 21 shkurt 2006,
- Kopja e librezës së punës,
- Një kopje të listës, të pavërtetuar e pa-vulosur nga ana e menaxhmentit të NSH, siç thuhet, me emra të punëtorëve dhe shuma të caktuara të pagave.

Arsyetimi ligjor

Kërkesa për rishikim-ankesa konsiderohet e pabazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit për DHPGJS (ligji nr.06/L-086) në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Në rastin konkret bazuar sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS është obligim i palës, në këtë rast ankueses, që në parashtrësat e saj me shkrim, ankesën, të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsyetimit ligjor mbi të cilin vendos qëndrimin dhe argumentimin e saj. Në rastin kur pala pohon, në këtë rast ankuesja, të ekzistojë një fakt, ajo palë është i obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi.

Nga dispozita e cekur si më lartë, është obligim i ankueses që të dëshmoj detyrimet ndaj saj, mbi mos pagesën e kompensimit të ardhurave personale.

Njoftimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe një listë e parashtruar, e pavërtetuar dhe panënshkruar nga ana e menaxhmentit të NSH, nuk paraqet dëshmi të mjaftueshme me të cilën ankuesja do të dëshmonte detyrimet e mbetura dhe të papaguara ndaj tij, nga ana e NSH.

Lidhur me pagat e papaguara si dhe kompensimit, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 dhe 1.6.2 parashihet:

- a. përmbushja e kërkesave për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person, si dhe
- b. e drejta në kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në .

Tutje sipas nenit 40 paragrafi 1.7, të shtojcës së Ligjit për AKP, parashihet përmbushja e kërkesave siç janë: “kërkesat e pasiguruara, përfshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë”.

Nga dispozitat e lartëcekura, mund të konkludohet se, punëtori/ja gëzon të drejtën në paga respektivisht dëmshpërblim nëse:

- a. pagat e punonjësit, në këtë rast ankueses, nuk janë paguar;

Andaj nga të gjitha arsyet e cekura si më lart ankuesja nuk ka dëshmuar të drejtën e saj mbi kompensimin siç edhe parashihet sipas nenit 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 dhe 1.7 por edhe nuk ka dëshmuar ndonjë obligim tjetër ashtu siç parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS

Nga gjitha arsyet u vendos si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesja ka paguar taksat gjyqësore.

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar